

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI
VENDIM

Nr. 41, datë 31.03.2026

PËR
MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN
E PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK, PËR DËMET QË U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI,
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 22, të nenit 14, të ligjit 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat e sigurimit “MTPL e brendshme” (tabela bashkëlidhur këtij vendimi).**
- 2. Shoqëria publikon primet e rrezikut, si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara gjatë gjithë periudhës së zbatimit.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI

Tabela: Primit e rrezikut të shoqërisë “Albsig” sh.a., për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, për kontratat e sigurimit “MTPL e brendshme”:

Kateg.	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm³)/ ose pesha mbajtëse (T)/ ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlogaritura (në Lekë)
A 1		Motorçikleta	Kapaciteti motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	3,200
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	5,200
B 1		Autovetura		11,100
B 2		Furgona, Mikrobusë	Numri i vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	15,500
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	21,000
C 1		Autobusë	Numri i vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	34,700
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	14,500
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	24,400
E 1		Rimorkio		7,100
F		Mjete bujqësore		5,500
G		Zjarrfikëse		12,700

*Tarifat e aplikuara për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.